

**ALARM TATIMOR**

**GUSHT 2020**

Për t'ju informuar me ndryshimet më të fundit në legjislacionin Shqiptar, ky alarm tatimor i përgatitur nga "A.R.S Legal & Financial Services" Ltd, ju ofron informata të vlefshme mbi procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19.

*Në fletoren zyrtare Nr. 144 datë 04.08.2020 është publikuar Vendimi Nr. 608, datë 29.7.2020 "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19".*

Qëllimi i VKM-së është përcaktimi i procedurave, kriterëve e rregullave për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë për shkak të Covid-19, gjatë periudhës 10 Mars 2020 – 23 Qershor 2020.

Të gjithë punëkërkuessit e regjistruar në zyrën e punës, të dalë të papunë për shkak të Covid-19 dhe të evidentuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kanë të drejtën të përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit.

Punëdhënësit, në mënyrë që të përfshihen në programin e nxitjes së punësimit duhet të paraqesin kërkesën në mënyrë elektronike, pas publikimit të informacioneve të nevojshme në Buletinin e Njoftimeve Publike apo në platforma të tjera (rrjete sociale, faqe interneti etj.) nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë / strukturat vendore, duke ngarkuar dokumentacionin e kërkuar. Në rast mospasje të metash në dokumentacion, kërkesa përcillet nga strukturat vendore përgjegjëse për miratim tek

**TAX ALERT**

**AUGUST 2020**

To keep you up to date with the latest changes in Albanian legislation, this tax alert prepared by "ARS Legal & Financial Services" Ltd provides you with valuable information on the procedures, criteria and rules to implementing the employment fostering program of persons resulting unemployed due to COVID-19.

*In the Official Gazette No. 144, dated 04.08.2020 is published the Decision No.608, dated 29.07.2020 "On the procedures, criteria and rules to implementing the employment fostering program through employment of persons resulting unemployed due to COVID-19".*

The aim of the DCM is to determining procedures, criteria and rules to implementing the program of promoting employment of people resulting unemployed due to Covid-19, from March 10 to June 23, 2020.

All jobseekers registered with the labor office, resulting unemployed due to Covid-19 and identified by the General Tax Directorate, are entitled to benefit from the employment fostering programs.

In order for Employers to be included in the employment fostering program must submit the application electronically, after the publication of the necessary information in the Bulletin of Public Notices or on other platforms (social networks, websites, etc.) by the institution responsible for employment and skills / local structures, uploading the required documentation. In case there are no defects in the documentation, the request is forwarded

struktura rajonale e punësimit. Kjo e fundit vendos miratimin ose jo të projektit brenda 5 (pesë) ditëve pune.

Kriteret paraprake që punëdhënësi duhet të plotësojë në mënyrë që të ketë drejtën e kërkesës janë si më poshtë vijon (i) të jetë shoqëri tregtare (ii) të jetë regjistruar si punëdhënës pranë organeve tatimore si dhe të mos ketë detyrime ndaj këtyre organeve para datës 10 Mars 2020, në të kundërt duhet të vërtetojë lidhjen e marrëveshjeve për shlyerjen e detyrimeve/ ka shlyer detyrimet por nuk ka paguar gjobat/ ka shlyer detyrimet ose ka vendosur garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit dhe është në proces apelimi administrativ apo gjyqësor me organet tatimore (iii) të mos ketë në ngarkim të tij, shkelje apo sanksione që lidhen me legjislacionin e punës, përgjatë dy viteve të fundit (iv) të ofrojë punë më kohë të plotë (minimumi 40 orë në javë) më pagë mujore jo më pak se paga minimale, si dhe (v) ***kërkohej që vendi i punës i krijuar të vijë si rezultat i rritjes së fuqisë punëtore në aktivitetin e tij.***

Punëdhënësi i cili përfshihet në këto programe punësimi përfiton mbështetje financiare (subvencionim) dhe mbulimi i kostove do të varet nga kohëzgjatja e programit të punësimit, i cili mund të jetë 4, 8 ose 12 muaj.

Pas nënshkrimit të kontratës së punës nënshkruhet marrëveshja tripalëshe për zbatimin e programit. Zgjidhja e kontratës së punës nga punëdhënësi, për shkaqe të pajustificuara passjell penalizim të tij me detyrimin për të kthyer 100% të mbështetjes financiare të përfituar deri në atë moment.

\*\*\*

from the local structures responsible for approval to the regional employment structure. The latter decides on approving or not of the project, within 5 (five) working days.

The prerequisite criteria that the employer must meet to be entitled to apply, are as follows: (i) to be a company (ii) to be registered as an employer with the tax authorities and to have no obligations to these bodies before 10 March 2020, otherwise must confirm the conclusion of agreements for the settlement of obligations / has settled the obligations but has not paid fines / has settled the obligations or has placed a bank guarantee for the full amount of the obligation and is in the process of administrative or judicial appeal with the authorities tax (iii) not to be in charge of violations or sanctions related to labor legislation, during the last two years (iv) to provide full-time work (minimum 40 hours per week) with monthly salary not less than the minimum wage, and (v) ***the job vacancy should come as a result of the increase in the workforce in its activity.***

The employer entailed in these employment programs shall benefit financial support (subvention) and the coverage of costs shall depend on the duration of employment program, which may be 4, 8 or 12 months.

After signing the employment contract, an agreement between three parties for the implementation of the program, shall be signed. The termination of the employment of contract, at the request of employer, for unjustified cause shall be followed by the punishment to giving back 100% of the financial support benefited until that moment.

\*\*\*

***Në Fletoren Zyrtare Nr. 146 datë 07.08.2020 është publikuar Ligji Nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i përditësuar më kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian në fushën e aviacionit.***

Qëllimi i këtij Ligji është rregullimi ligjor i përdorimit të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe të marrëdhënieve juridike në fushën e transportit ajror si dhe rregullimi i veprimtarisë së avionëve civilë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, të avionëve të regjistruar në një shtet tjetër, por që operojnë me licencën e operimit të lëshuar nga autoriteti kompetent licencues i Republikës së Shqipërisë, të avionëve civile për të cilët Republika e Shqipërisë merr apo transferon përgjegjësi në përputhje me Nenin 83 *bis* të Konventës së Çikagos, aeroporteve ose pjesëve të aeroporteve, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë e që nuk janë ekskluzivisht në përdorim për qëllime ushtarake; operatorëve të aeroportit/aeroporteve, transportuesve ajrorë, ofruesve të shërbimeve të lundrimit ajror dhe ofruesve të shërbimeve të tjera aeroportuale; të gjitha subjekteve, persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që kanë detyrë të zbatojnë standardet dhe praktikat e rekomanduara të ICAO-s dhe operojnë brenda ose jashtë aeroportit/aeroporteve.

Ligji i ri mundëson qartësim të dispozitave ligjore si dhe parashikon rregullime të reja sikurse është harmonizimi i veprimeve përsa i përket përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore. Sipas Nenit 9 të Kodit Ajror Ministri përgjegjës për transportin ajror dhe Ministri përgjegjës për mbrojtjen janë përgjegjës për organizimin e hapësirës kombëtare dhe rregullimin e përdorimit të saj.

Parashikohet gjithashtu krijimi i Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare me drejtues Drejtorin Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, dhe ka në përbërje

***In the Official Gazette No. 146, dated 07.08.2020 is published Law No. 96/2020 “Air Code of the Republic of Albania”, in compliance with the regulatory framework of the EU in the aviation discipline.***

The purpose of this law is to governing the exploitation of airspace of the Republic of Albania and the judicial relations in the field of aerial transport as well as regulating the activity of civil airplanes registered in the Republic of Albania, of civil airplanes registered in another country but operating on the basis of an operating licence issued by the competent licencing authority of the Republic of Albania, of civil airplanes for which the Republic of Albania bears or conveys responsibility in accordance with Article 83 *bis* of the Convent of Chicago, airports or parts of them located within the territory of the Republic of Albania and not being exclusively used for military purposes; operators of airport(s), aerial transporters, providers of air navigation services and providers of other airport services; of all subjects, natural or legal persons, nationals or foreigners, whose duty is to perform/implement the ICAO’s recommended standards and practices and also operate within or outside the airport(s).

The new law provides for clarification of the legal provisions in additon to new regulations such as the harmonisation of actions related to the flexible explotation of airspace. According to Article 9 of Air Code, the responsible Minister for aerial transport and dhe responsible Minister of defence are duly responsible to organise the national space and regulate its exploitation.

Furthermore, it is postulated the establishment of the Airspace Management Committee, lead by the Executive Director of Civil Aviation Authority and consisting

të tij 5 anëtarë i) Komandantin e Forcave Ajrore ii) një përfaqësues nga struktura për politikën e transportit në ministrinë përgjegjëse për transportin; iii) një përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura (FA); iv) përfaqësues nga ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror; v) përfaqësues nga përdoruesit e tjerë të hapësirës ajrore, në rolin e vëzhguesve.

Një risi tjetër është edhe krijimi i Programit Shtetëror të Sigurisë së Operimit, i cili krijohet, përditësohet e zbatohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil si dhe miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Programi Shtetëror i Sigurisë në Operim bazohet në objektivat strategjike kombëtare në fushën e transportit ajror dhe specifikon nivelin e pranueshëm të performancës së sigurisë në operim, të synuar për t'u arritur gjatë kryerjes së aktiviteteve të aviacionit.

Referuar Nenit 20 të Ligjit Nr. 96/2020 kushtet për marrjen e licensës së operimit janë qartësuar dhe më konkretisht: specifikohet se një ndër kriteret për marrjen e licensës së operimit është që veprimtaria e sipërmarrësit të ushtrohet kryesisht në Republikën e Shqipërisë, ndërsa me ligjin Nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, kërkohej që në rast se vendi kryesor i veprimtarisë nuk ishte Republika e Shqipërisë, atëherë zyra e regjistrimit të biznesit duhet të ishte në shtetin shqiptar. Më tej është qartësuar kriteri zotërimit të më shumë se 50% të kapitalit të sipërmarrjes dhe pasja e kontrollit efektiv, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, nëpërmjet një ose më shumë sipërmarrjeve ndërmjetëse, nga shteti shqiptar dhe/ose shtetas shqiptar, shteti i ZPEA-së ose shtetasit e shteteve të ZPEA-së (duke marrë në konsideratë edhe Marrëveshjet dy apo shumëpalëshe ku shteti shqiptar është palë). Një element shtesë në dispozitë është pasja e reputacionit të mirë të personave që e drejtojnë efektivisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë

on 5 members as follows: i) Commander of the Air Forces ii) a representative from the transport policy structure in the ministry responsible for transport; iii) a representative from the General Staff of the Armed Forces (AF); iv) representatives from air navigation service providers; v) representatives from other airspace users, in the role of observers.

Another novelty is the establishment of the State Operational Security Program, which is compiled, updated and implemented by the Civil Aviation Authority and approved by a Decision of the Council of Ministers. The State Operational Security Program is based on national strategic objectives in the field of aerial transport and specifies the acceptable level of operational safety performance, intended to be achieved while performing the aviation activities.

Referring to Article 20 of the Law No. 96/2020 the criteria to obtain the operating license are clarified and more precisely: in comparison with Law No. 10 040, dated 22.12.2008 “Air Code of the Republic of Albania”, it is specified that exercising the activity mainly in the Republic of Albania is a condition to be fulfilled in order to obtain the operating license, while the Law to be abolished required that if the main place of exercising the activity was not the Republic of Albania, then the business registration office had to be in the Albanian state. Further, it is clarified the criteria of owning more than 50% of the shares of the company and having effective control, directly or indirectly, through one or more intermediary enterprises, by the Albanian state and / or Albanian citizen, the ECAA countries or citizens of ECAA’s countries (taking into account the bilateral or multilateral agreements to which the Albanian state is a party). An additional element in this provision is the good reputation that should

sipërmarrjen ose të mos qënit deklaruar zyrtarisht e falimentuar.

Referuar Relacionit Shoqërues për Ligjin Nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, ky i fundit përveç ndryshimeve të dispozitave ekzistuese, bën një saktësim nga ana gjuhësore dhe standardizim të të gjithë termave në fushën e aviacionit civil, por pa ndryshuar strukturën e ligjit nr.10 040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 10 040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe aktet nënligjore të cilat bien në kundërshtim me parashikimet e këtij Kodi.

\*\*\*

***Në Fletoren Zyrtare Nr. 149 datë 13.08.2020 është publikuar Ligji Nr. 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, i cili do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.***

Ky ligj ka për qëllim krijimin, funksionimin dhe administrimin e Regjistrin të Pronarëve Përfitues, përkufizimin e termit “Pronar përfitues” dhe përcaktimin e subjekteve të cilat kanë detyrimin për regjistrim të pronarëve përfitues si dhe rregullon procedurën dhe mënyrën e regjistrimit dhe mbajtjes së të dhënave të regjistruara të pronarëve përfitues. Ligji parashikon gjithashtu edhe masa ndëshkuese në rast të mosrespektimit të kërkesave ligjore për regjistrimin e pronarëve përfitues.

be carried by the persons who run the business effectively and directly or not being officially declared bankrupt.

Referring to the accompanying report for the Law No. 96/2020 “ Air Code of the Republic of Albania”, the latter in addition to amendments to the existing provisions, constructs linguistic specification and standardization of all terms in the field of civil aviation, without amending the structure of law no. 10 040, dated 22.12.2008, “Air Code of the Republic of Albania”, as amended. By entering into force, Law No. 10 040, dated 22.12.2008, "Air Code of the Republic of Albania", as amended and bylaws to the contrary contained in the provisions of this Code shall be abrogated.

\*\*\*

***In the Official Gazette No. 149, dated 13.08.2020 is published Law No. 112/2020 “On the Register of Beneficial Owners”, which shall enter into force 15 days after its publication in the Official Gazette.***

This law aims at establishing, functioning and administering of the Register of Beneficial Owners, defining the term “Beneficial owner” and ruling the subjects who are duly obliged to register the beneficial owners as well as regulating the procedure and manner of registering and keeping the registered data of the beneficial owners. The law in addition postulates penalties in case of failure to meet the legal requirements to registering the beneficial owners.

Ky ligj aplikohet për personat juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ku përfshihen: i) 4 format kryesore të shoqërive (shpk, sha, shk, shkm) ii) zyrat e përfaqësimit dhe degët e shoqërive të huaja; iii) shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre; iv) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë; v) shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor; vi) çdo subjekt tjetër juridik, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së; vii) organizatat jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja, të regjistruara në regjistrin e organizatave jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë; viii) personat juridikë dhe ndërmarrjet, të cilët kanë aksionarë, përveç institucioneve qendrore dhe/ose vendore të Republikës së Shqipërisë, edhe individë/persona juridikë të tjerë shqiptarë dhe/ose të huaj.

Referuar Nenit 2/2, ligji nuk është I zbatueshëm për i) personat fizikë, tregtarë të regjistruar në regjistrin tregtar; ii) partitë politike iii) komunitetet fetare iv) personat juridikë dhe ndërmarrjet aksionar i vetëm i të cilave janë institucionet qendrore/vendore të Rëpublikës së Shqipërisë.

Në referim të Nenit 3 të ligjit, me “pronar përfitues” do të kuptohet individi i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit subjektin dhe/ose individi në emër të të cilit po kryhet një transaksion dhe përfshin të paktën:

a) Individi i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të një përqindje të mjaftueshme të aksioneve ose të drejtave të votimit ose të pjesëmarrjen në kapitalin e atij entiteti, përfshirë përmes mbajtjes së aksioneve, ose përmes kontrollit nëpërmjet mjeteve të tjera, ose përfiton nga transaksionet e kryera nga personi juridik në emër të tij;

This law is applicable to legal persons registered in the Republic of Albania, including: i) the 4 main companies’ structure (Ltd, jsc, ce, LP) ii) representative offices and branches of foreign companies iii) savings and loan associations and their unions; iv) mutual cooperation societies; v) agricultural cooperation companies; vi) any other legal entity, which by law is obliged to register with the NBC; vii) non-profit organizations, including foundations, associations, centers, as well as branches of foreign non-profit organizations, registered in the register of non-

profit organizations in the Republic of Albania;

viii) legal persons and enterprises, which in addition to central and/or local institutions of the Republic of Albania, have as shareholders other albanian/foreign natural/legal persons.

Referring to Article 2/2, this law is not applicable to i) physical persons, enterprisers registered in the commercial register; ii) political parties; iii) religious communities iv) legal persons and enterprises whose sole shareholders are central/local institutions of the Republic of Albania.

In the light of Article 3 of the law, “beneficial owner” is an individual who owns or ultimately controls the subject and/or the individual on behalf of which a transaction is being proceeded and involves at least:

a) an individual who ultimately owns or controls a legal person, through direct or indirect ownership of a sufficient percentage of the shares or voting rights or participation in the capital of that entity, including through the holding of shares, or through control by other means, or benefits from transactions carried out by the legal person on its behalf;

b) Themeluesi ose përfaqësuesi ligjor ose individ i që ushtron kontrollin e fundit efektiv në administrimin dhe kontrollin e organizatave jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse;

c) Në rastin e një trusti ose marrëveshjeve të tjera ligjore:

Krijuesi i trust-it, kujdestari/i mirëbesuari, mbrojtësi, nëse ka, dhe përfituesit ose kur personat që përfitojnë nga marrëveshja ligjore ose entiteti ende nuk janë përcaktuar, klasa e personave për interesin kryesor të të cilëve marrëveshja ligjore ose entiteti është krijuar ose operon; çdo individ tjetër që ushtron kontrollin e fundit mbi trustin me anë të pronësisë direkte (zotërimi i 25% ose më tepër i aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues) ose indirekte (pronësia e mbajtur ose kontroll i ushtruar nga i njëjti individ në një/më shumë persona juridikë, të cilët vecmas apo së bashku zotërojnë 25% ose më shumë të aksioneve/kuotave të kapitalit të një subjekti raportues) ose me mjete të tjera.

*Regjistri i Pronarëve Përfitues* (“RPP”) është një bazë të dhënash elektronike shtetërore, në të cilin regjistrohen të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve që kanë detyrimin e raportimit dhe administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në RPP regjistrohen:

(i) të dhëna të përgjithshme për subjektin raportues (NUIS, emri i subjektit);

(ii) të dhëna të detyrueshme për pronarët përfitues të subjektit raportues (të dhënat e identifikimit, data e përcaktimit të individit si pronar përfitues, lloji dhe përqindja e pronësisë). Këto të dhëna ruhen përherë në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, me përjashtim të rastit kur subjekti raportues c’regjistrohet nga regjistrat përkatës. Në këtë rast, të dhënat ruhen edhe për

b) the founder or legal representative or the individual who exercises the ultimate effective control over the administration and control of non-profit organizations, including foundations, associations, centers, and branches of non-profit organizations;

c) in case of a trust or other legal agreements: Founder of trust, custodian / trustee, protector, if there is any, and beneficiaries or when the persons benefiting from the legal agreement or the entity is not determined yet, the category of people for whose primary interest the legal agreement or entity is established or operates; any other individual who exercises the ultimate control over the trust throughout direct ownership (possession of 25% or more of shares / equity shares or ownership interests in a reporting subject) or indirect (ownership held or control exercised by the same individual in one / more legal entities, who separately or jointly own 25% or more of the shares / equity shares of a reporting subject) or by other means.

*The Register of Beneficial Owners* (“RBO”) is a state electronic database, in which records of beneficial owners of subjects that are obliged to report are registered and it is administered by the National Business Center. In RBO is registered:

(i) general data of the reporting subject (NUIS, subject’s name);

(ii) mandatory data of the beneficial owner of the reporting subject (identification’s records, the date of obtaining the beneficial owner status; type and percentage of ownership.

The abovementioned information shall be permanently saved in the Register of Beneficial Owners, excluding the occasion when the reporting subjects unregister from relevant registers. In the latter case, data shall be saved for also 10 years starting from

10 vjet nga data e c'registrimit të subjektit raportues.

Personat juridik të regjistruar në Republikën e Shqipërisë (*subjektet raportuese*) detyrohen të mbajnë të dhëna dhe dokumentë në bazë të të cilave përcaktohen pronarët përfitues të subjektit dhe lloji i kontrollit të pronarëve përfitues, ndërsa këta të fundit kanë detyrimin ligjor t'u japin subjekteve raportuese të gjithë dokumentacionin e nevojshëm me qëllim regjistrimin e pronarëve përfitues, sipas afateve të mëposhtme:

i. regjistrimi fillestar i pronarëve përfitues, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese

*(mospërmbushja e këtij detyrimi dënohet me gjobë në vlerën 500.000 lekë);*

ii. regjistrimi i ndryshimeve në të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve raportuese, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ndodhjes së ndryshimit faktik *(mospërmbushja e këtij detyrimi dënohet me gjobë në vlerën 250.000 lekë);*

***\*Për shkeljet e mësipërme dënohet me gjobë në vlerën 150.000 lekë edhe përfaqësuesi ligjor i personit juridik të regjistruar.***

Në mënyrë të përmbledhur, Neni 6 I ligjit parashikon mënyrën e regjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues, subjektet që legjitimohen të kryejnë regjistrimin/ndryshimin e të dhënave, organi kompetent për miratimin apo refuzimin e aplikimit për regjistrim dhe afatin brenda të cilit merret vendimi për regjistrimin apo jo të të dhënave të pronarëve përfitues.

Personi i cili është regjistruar si pronar përfitues por pretendon se nuk është pronar përfitues I subjektit raportues, ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatën kompetente. Qendra Kombëtare e Biznesit korrigjon kryesisht të dhënat e pronarit përfitues brenda 2 ditëve pune nga depozitimi i

the date of deregistration of the reporting subject.

Legal persons registered in the Republic of Albania (*reporting subjects*) are obliged to bear data and documents on the basis of which beneficial owners of the subject and the sort of control of the beneficial owners are determined, while the latter are legally obliged to provide the reporting subject with all the necessary documents, in order to proceed with the registration of the beneficial owners, according to the following deadlines:

i. initial registration of the beneficial owners, within 30 calendar days starting from the date of registration of reporting subjects *(failure to meet this liability shall be followed by a fine at the amount of ALL 500.000);*

ii. registration of amendments over beneficial owners' data of reporting subjects, within 30 calendar days starting from occurrence of factual change *(failure to meet this liability shall be followed by a fine at the amount of ALL 250.000).*

***\*The legal representative of the registered legal person shall be penalized by a fine at the amount of ALL 150.000 for the abovementioned infringements.***

In a nutshell, Article 6 of the law prescribes the manner of registering data of the beneficial owners, legitimated subjects to carry out registration/alteration of data, the competent entity to approve or refuse the application for registration as well as the deadline within which the decision to register or not the data of the beneficial owners is to be taken.

A person who is registered as a beneficial owner but alleges to not being the beneficial owner of the reporting subject, is entitled to file a lawsuit with the competent court. The National Business Center reflects par excellence the data of the beneficial owner



vendimit të gjykatës, i cili ka marrë formë të prerë.

Subjektet raportuese ekzistuese duhet të identifikojnë pronarët përfitues dhe të krijojnë e mbajnë dokumentet përkatëse për ta brenda datës 31.12.2020. Të dhënat e kërkuara nga ligji për pronarët përfitues duhet të regjistrohen nga subjektet raportuese ekzistuese jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga krijimi i regjistrit.

Në zbatim të Nenit 15/2, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit do të krijojnë RPP jo më vonë se data 31.1.2021.

\*\*\*

***Në fletoren zyrtare Nr. 153 datë 24.08.2020 është publikuar Udhëzimi i Përbashkët Nr. 12, datë 21.7.2020 “Për përcaktimin e numrit të faqeve për të cilat informacioni përfitohet falas, rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifës, si dhe rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës për pajisjen me informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”.***

Udhëzimi ka për qëllim të përcaktojë subjektet të cilat përfitojnë pa pagesë riprodhimin e informacionit deri në 20 faqe, ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër. Subjektet përfitues janë personat e regjistruar në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, të listuar në pikën 2 të Udhëzimit.

Autoriteti Publik i cili do të kryejë riprodhimin e dokumentacionit/informacionit, njofton subjektin kërkuar mbi shumën që duhet paguar për riprodhim të informacionit (kur ky i fundit

within 2 working days from the deposition of the Court’s decision, which has become final.

Existing reporting subjects must identify the beneficial owners, establish and keep their relevant documents within 31.12.2020. The required data by law for the beneficial owners must be registered by existing reporting subjects no later than 60 calendar days from the foundation of the register.

In order to implement Article 15/2, the Ministry of Finance and Economy and the National Agency for Information Society shall constitute the RBO no later than 31.1.2021.

\*\*\*

***In the Official Gazette No. 153, dated 24.08.2020 is published the Common Instruction No. 12, dated 21.7.2020 “On determining the number of pages for which the information is obtained free of charge, instances of exemption from the payment of fee, as well as regulations for the manner of payment to obtaining information produced or beared from public authorities”.***

The Instruction aims at setting out subjects that benefit the reproduction of information up to 20 pages or equivalent if the information is delivered in another format, free of charge. Beneficial subjects are persons registered for the social assistance schemes, and beneficial subjects in accordance with Law No. 111/2017, “On legal assistance vouched by the states”, listed on point 2 of the Instruction.

The public authority which shall conduct reproduction of documents/information, notifies the interested person on the value

tejkalon 20 faqe), dhe pas kryerjes së pagesës në një bankë të nivelit të dytë, për llogari të autoriteti publik, ky i fundit dërgon informacionin e kërkuar me postë ose ia dorëzon menjëherë të interesuarit.

Pavarësisht rregullimeve të sipërpërmendura, ato do të jenë të paaplikueshme për subjektet për të cilat marrja e shërbimit përcaktohet me ligj që të jetë falas.

\*\*\*

*Në Fletoren Zyrtare Nr. 154, datë 26.08.2020 është publikuar Ligji Nr. 106/2020 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare si dhe Ligji Nr.107/2020 “Për një shtesë në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar i cili hyn në fuqi më 1 Janar 2021.*

Ligji Nr.106/2020 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, parashikon dy ndryshime, dhe konkretisht:

***1) Mbi subjektet që i nënshtrohen tatimit mbi fitim***

a. Në Nenin 16/1, shkronja a) e ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar parashikohet se i nënshtrohen tatimit mbi fitim: i) shoqëritë tregtare, të themeluara sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, personat e tjerë juridikë të themeluar sipas Kodit Civil, të cilët ushtrojnë veprimtari fitimprurëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat e tjerë juridikë të themeluar ose të njohur si të tillë me

that should be paid for such service (if such reproduction of information exceeds 20 pages), and after payments is completed through a bank of second level, on behalf of the public authority, the latter delivers the required information by post or submits it immediately to the interested subject.

Regardless of the above mentioned regulations, they shall be unapplicable to subjects for which reception of service is determined by law to be given free of charge

\*\*\*

*In the Official Gazette No. 154, dated 26.08.2020 is published Law No. 106/2020 “On some amendments to Law No. 8438, dated 28.12.1998 “On income taxation”, which shall enter into effect 15 days after its publication in the Official Gazette and Law No. 107/2020 “On an addition to Law No. 8438, dated 28.12.1998 “On income taxation”, as amended which shall enter into force on 1 January, 2021.*

Law No. 106/2020 “On some amendments to Law No. 8438, dated 28.12.1998 “On income taxation, as amended, provides for two changes, and more precisely:

***1) Subjects that fall under profit tax***

a. Article 16/1, letter a) of Law No. 8438, dated 28.12.1998 “On income taxation”, as amended, sets out that the following subjects fall under profit tax: 1) companies, established according to Law “On entrepreneurs and commercial companies”, other legal persons established in accordance with Civil Code, which exercise profitable-activity in the Republic of Albania, as well as other legal persons established or regocnized as such by special laws, and ii)

ligje të veçanta, dhe ii) "ortakëritë", të cilët janë subjekte të regjistruara për TVSH-në.

***Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.106/2020 do ti nënshtrohen tatimit mbi fitim personat juridikë dhe ortakëritë e përmendura më sipër, të cilat kanë të ardhura mbi 8.000.000 lekë në vit.***

Pra, ndryshimi konsiston në përcaktimin e të ardhurave (mbi 8 000 000 lekë në vit) në dallim nga parashikimi i mëparshëm (subjekte të regjistruara për TVSH-në), si kriter për përfshirjen e tyre në skemën e tatimit mbi fitim.

b. Gjithashtu, do ti nënshtrohet tatimit mbi fitim cdo person tjetër, pavarësisht statusit apo formës ligjore të regjistrimit apo njohjes së tij (*dhe pavarësisht se është subjekt i TVSH-së apo jo*). Mbetet i pandryshuar përjashtimi ligjor për këto subjekte, për të cilët nuk është i aplikueshëm tatimi mbi fitim nëse i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël.

*Pikat e tjera të Nenit 16 mbeten të pandryshuara.*

## ***2. Shkalla e tatimit***

Në vijim, me ligjin nr. 106/2020 është ndryshuar shkalla e tatimit mbi fitim për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit. Për këta të fundit, shkalla e tatimit **nga 5% është reduktuar në 0%.**

***Ndryshimet e mësipërme do ti shtrijnë efektet nga data 1 janar 2021.***

***Në Ligjin Nr. 107/2020, në Nenin 8/1 në të cilin parashikohen të ardhurat që përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale, krahas***

“partnerships”, which are registered for the VAT.

***Upon entrance into force of Law No. 106/2020, legal persons and partnerships mentioned above, which have incomes above the amount of ALL 8.000.000 per year, shall fall under profit tax.***

In conclusion, the amendment consists on setting out the incomes (above ALL 8.000.000 per year) compared to the previous postulation (subjected registered for the VAT), as the criteria to involving subjects into the profit tax scheme.

b. In addition, shall be subject to profit tax any other person, regardless of the status or legal form of registration or its recognition (*and despite that it is subject to the VAT or not*). The legal exception related to the non-application of profit tax provided that these subjects fall under the implied profit tax on small businesses, remains unchanged.

*Other matters of Article 16 remain unchanged.*

## **2. Tax rate**

Further, with law no. 106/2020, the profit tax rate for taxpayers with incomes up to 14,000,000 ALL per year has been changed. For the latter, the tax rate **has been reduced from 5% to 0%.**

***The above amendments will commence the effects from 1<sup>st</sup> of January 2021.***

***In Law No. 107/2020, in Article 8/1 which provides for incomes that are exempted from personal income tax, in addition to other***

parashikimeve të tjera në këtë nen, pas pikës 10 që përcakton se përjashtohen të ardhurat e përfituara nga institucionet shtetërore për arritjet në shkencë, sport, kulturë, shtohen si të ardhura të përjashtuara edhe “pagat dhe shpërblimet e çdo lloji të sportistëve, që kanë kontrata të rregullta me klubet sportive, të cilat njihen nga federatat përkatëse sportive, të përfituara gjatë periudhës 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2022.”

***Ndryshimi i lartpërmendur hyn në fuqi në 1 Janar 2021.***

***Në fletoren zyrtare Nr. 153 datë 24.08.2020 është publikuar Udhëzim nr. 32, datë 25.8.2020 Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili hyn menjëherë në fuqi.***

Në lidhje me normativat e përdorimit të gazoilit për veprimtarinë **Transport Udhëtarësh**, sa i përket kufizimit të zbritjes së TVSH ka ndryshuar norma nga “deri në 43%” në “deri në 100 %”.

\*\*\*

*Nëse dëshironi të dini më shumë për ndryshimet në legjislacionin shqiptar, na kontaktoni si më poshtë:*

Email: [info@arsfirm.al](mailto:info@arsfirm.al)  
Telefon: 069 247 6387  
web: [www.arsfirm.al](http://www.arsfirm.al)

provisions in this article, after point 10 which stipulates that incomes received from state institutions for achievements in science , sports, culture are excluded, “salaries and bonuses of any type of sportist who have regular contracts with sports clubs, which are recognized by the relevant sports federations, obtained during the period from 1 January 2021 to 31 December 2022” are added as excluded incomes.

***The above mentioned amendmend enters into force on 1 January 2021.***

***In the Official Gazette No. 153, dated 24.08.2020 is published Instruction no. 32, dated 25.8.2020 “On an amendment to Instruction no. 6, dated 30.1.2015 “On the Value Added Tax in the Republic of Albania”, as amended, which enters into force immediately.***

In relation with norms of exploitation of gasoil for the activity “**Transport of Travelers**, regarding the restriction of reduction of the VAT, the norm has changed from “up to 43%” to “up to 100%”.

\*\*\*

*If you wish to know more on the albanian legislation, contact us as follows:*

Email: [info@arsfirm.al](mailto:info@arsfirm.al)  
Phone: +355 69 978 9625  
Web: [www.arsfirm.al](http://www.arsfirm.al)

**Adresa e zyrës**

Rruga "Kavaja"  
Qendra " Sun Tower ",  
Kati 8<sup>të</sup>, Ap. Nr 30,  
Tiranë, Shqipëri

©A.R.S Legal & Financial Services

**Office Address**

"Kavaja" Street  
"Sun Tower" Center  
8<sup>th</sup> Floor, Apt no. 30  
Tirana, Albania

©A.R.S Legal & Financial Services